



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
SHËRBIMI LEGJISLATIV  
SHËRBIMI JURIDIK

Nr. 2720/3 Prot.

Tiranë më 10.11.2023

Lënda: Dërgim vendimi

**KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Vendim nr. 116/2023 “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 34/2010 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Genci GJONCAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

VENDIM

Nr. 116/2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 34/2010  
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT  
TË POZICIONEVE TË PUNËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN  
NGA DISKRIMINIMI”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, nenit 21, pika 3, të ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 2 e vendimit të Kuvendit nr. 34/2010 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

Miratuar në datën 2.11.2023

KRYETARE

Lindita NIKOLLA



Lidhja 2

**ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS SË KOMISIONERIT  
PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

<u>Funksioni</u>	<u>Nr. i punonjësve</u>	<u>Kategoria/Klasa</u>
<b>I. Komisioneri</b>	<b>1</b>	F
		Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010, i ndryshuar
<b>II. Kabineti</b>	<b>2</b>	
Këshilltar	1	I- 4
Sekretar	1	VKM 325/2023 lidhja nr.5 tabela nr.2, pika 3
<b>III. Drejtoria e Pritjes së Ankesave</b>	<b>6</b>	
Drejtor	1	II-1
Specialist	2	IV-2
Specialist – Shkodër	1	IV-2
Specialist – Korçë	1	IV-2
Specialist – Fier	1	IV-2
<b>IV. Drejtoria e Hetimit Administrativ</b>	<b>6</b>	
Drejtor	1	II-1
Inspektorë	5	III-1
<b>V. Drejtoria Juridike</b>	<b>5</b>	
Drejtor	1	II-1
Specialist	4	IV-1
<b>VI. Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë 6</b>		
Drejtor	1	II-1
Specialist i Marrëdhënieve me Jashtë	1	IV-1
Specialist të Monitorimit dhe raportimit	2	IV-1
Specialist i Komunikimit me Mediat	1	IV-1
Specialist i Jetësimit të Projekteve	1	IV-1
<b>VII. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Financiare</b>	<b>8</b>	
Drejtor	1	II-1
Specialist i burimeve njerëzore	1	IV-1
Specialist IT	1	IV-1
Specialist i Buxhet-Financës	1	IV-1
Specialist i Arkiv-Protokollit	1	IV-2
Magaznier/punonjës mirëmbajtje	1	Klasa V.(VKM 326/2023)

Shofer	1	Klasa III (VKM 326/2023)
<u>Pastrues</u>	<u>1</u>	<u>Klasa I .(VKM 326/2023)</u>
<b>Gjithsej:</b>	<b>34 punonjës</b>	